SHABAN ÇUPI

RAPORT INTERN MBI TORTURAT E RANKOVIQIT NË KOSOVË GJATË VITIT 1956

Çka është ky dokument që po publikohet?

Është një raport i përbashkët ndërkomunal i hartuar nga Kuvendi komunal i Ferizajt dhe i Kaçanikut.

Ishte publik apo jo?

Jo, ishte intern.

Në cilin vit u hartua ky Raport?

U hartua në marsin e vitit 1967 dhe ka 23 faqe të formatit A4.

Si titullohej Raporti?

Raporti mbi punën e komisionit ndërkomunal shtetëror për konstatimin e deformimeve dhe marrjen e masave në riorganizimin e Shërbimit në Sigurimin Shtetëror.

Kur u hartua ky Raport?

Ky Raport u hartua siç thamë në vitin 1967, pas Plenumit të Brioneve.

Kur u mbajt Plenumi i Brioneve?

Plenumi i katërt i Komitetit Qendror të Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë u mbajt më 1 korrik të vitit 1966 në ishullin e Brioneve në Kroaci.

Pse është i rëndësishëm ky Plenum?

Sepse në këtë Plenum, nga Josip Broz Tito u shkarkua Aleksandër Rankoviqi.

Po kush ishte Aleksandër Rankoviqi?

Ishte një serb, partizan komunist dhe bashkëpuntorë i Titos dhe udhëheqte sektorin e sigurisë në nivel jugosllav dhe gjatë periudhës së tij 1945-1966 bëri shumë reprezalje mbi popullatën shqiptare.

Kur vdiq Rankoviqi?

Ai kishte lindur më 28 nëntor 1909 në Drazhevac të Serbisë, ndërsa vdiq në Beograd më 19 gusht 1983. Pas Plenumit të Brioneve dhe shkarkimit të tij ai u tërhoq nga jeta politike publike, por varrimi i tij në Beograd u shndërrua në një tubim të madh publik ku morën pjesë dhjetëra mijëra njerëz.

Ç`don të thoshte kjo?

Kjo don të thotë se ideologjia antishqiptare e Rankoviqit në Serbi ishte e thellë. Koha e dëshmoi një gjë të tillë.

Si vepronte aparati i dhunës ndaj shqiptarëve, udhëhequr nga Rankoviqi?

Sektorin e sigurisë e udhëhiqte shërbimi sekret OZNA. Më pas OZNA ndryshoi emrin në UDBA dhe brenda UDB-së vepronin inspektorët që torturonin shqiptarët në mënyrë mizore.

Pse viti 1956 për atë kohë ishte kulmi i dhunës ndaj shqiptarëve në Kosovë dhe jo vetëm?

Viti 1955/ 1956 njihet si viti i aksionit për dorëzimin e armëve. Armët kërkoheshin nga shqiptarët që t`i dorëzonin. Në fakt, shqiptarët luftonin për mbijetesë buke, sepse fill pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore (LDB) dhe marrjes së pushtetit nga komunistët jugosllavë, në popull kërkohej ,,otkupi " ose dorëzimi i tepricës e në fakt shqiptarët nuk mund ta siguronin as kotheren e bukës. Në këto rrethana, shumë shqiptarë u larguan për në Turqi ku jetojnë edhe sot. Pjesa që mbet në Kosovë dhe vise, arrestoheshin dhe burgoseshin si mbetje balliste e reaksionare. UDB-a duke i parë këto suksese të tyre, sajuan Aksionin për dorëzimin e armëve dhe ishte fatal për popullatën shqiptare.

Pse fatal?

Sepse shqiptarët torturoheshin në masë për dorëzim arme që nuk e kishin. Nga torturat e rënda, armët bliheshin, po nga rrjeti i UDB-së dhe dorëzoheshin. Kishte raste, madje shumë sosh që tinëzisht arma natën shqiptarit i futej në shtëpi ose ua fshehnin në mullarët e barit dhe të nesërmen kërkohej i zoti i shtëpisë për dorëzim arme. Pas torturave të rënda, e merrnin viktimin e dërgonin te mullari ose te vendi ku UDB-a kishte fshehur pushkën dhe në këtë mënyrë arsyetonin dhunën.

Çka shkruan në Raport rreth kësaj situate?

Edhe pse Raporti është sipërfaqësor ai megjithate jep disa të dhëna me vlerë. Në Raport shkruhet se vetëm në Ferizaj e Kaçanik, duke përfshi edhe Hanin e Elezit janë torturuar në masë 88 copë katunde. Nga torturat njerëzit kanë pësuar lëndime të rënda e disa edhe janë çmendur. Kështi ishte në tërë Kosovën.

A e përfshiu trevën e Hanit të Elezit, aksioni i armëve?

Po. Aksioni u krye në çdo fshat. U dorëzuan edhe armë, por edhe u rrahën shumë banorë të kësaj ane.

Mund të veçoni ndonjë rast?

Tham edhe më lartë që janë torturuar shumë njerëz, por veçohen torturat që i janë bërë hoxhës Sami Bushit dhe kuririt të shkollës Selam Dernjanit nga fshati Paldenicë.

Ku u torturuan ata?

Sami Bushi, edhe pse jetonte në Han të Elezit, u torturua në shkollën e Gorancës, ndërsa Selam Dernjani pasi futej në gropë të gëlqeres me ujë e akull, futej në objektin e shkollës dhe rrahej me dru.

Mund të na përshkruani llojin e torturave?

Pos kërbaçit, shqiptarët torturoheshin me druj, pastaj futja e tyre në ujë të ftohtë në acarin dimëror, pastaj varja e peshave në organet gjinitale, lidhja për lisi, pirja e ujit të kriposur, shkulja e thonjëve, futja e vezëve të ziera dhe të nxehta nën sqetull, furja, varja, detyrimi që shqiptari të rrah shqiptarin e shumë të tjera.

Kush i torturoi, i dini emrat e udbashëve?

Po. Në trevën e Hanit të Elezit, torturat i bënin Qazim Metahusa i Gjakovës dhe Pera i Muzeqinës dhe bashkëpunëtorët e tyre që në popull njihen si Bijtë e Rankit.

Kishte shum të tillë?

Fatëkeqësisht po. Asnjë pushtues nuk mundet ta mbaj të pushtuar një popull, nëse nuk ka bashkëpuntorë të tyre. Posllanika e poverenika kishte sa të duash, prandaj zgjatej jeta e pushtuesit serb në Kosovë.

Në cilin vend UDB-a torturonte shqiptarët?

Torturat bëheshin kudo. Përveç në stacione të policisë e burgje, torturat bëheshin edhe në vende publike, por më së shumti në objekte shkollore, duke krijuar një traumë të thellë tek shqiptarët.Torturat bëheshin me kërbaq e druj.

Po Titoja a i dinte këto?

Natyrisht që i dinte dhe s`kishte si të mos i dinte, por kur kuptoi se Aleksandër Rankoviqi inçizuesit sekret i kishte futur edhe në zyren e Titos, atëherë ai ndërmori masa dhe e shkarkoi ate. Tani në pyetje ishte fati i tij.

Po cili ishte synimi kryesor i Raportit?

Pas rënies së Rankoviqit, dhe dënimi i disa udbashëve për deformime gjatë punës së tyre, komisioni kishte për detyrë që t`i hulumtoj keqpërdoruesit, ata që tejkaluan përdorimin e forcës dhe të bënte riorganizmin e Shërbimit të Sigurimit.

A i arritën qëllimit që synonin?

Në disa segmente po. Shumë udbash u shkarkuan, por megjithate mbetën shumë të tjerët të cilët patëm edhe ne fatin t`i njohim gjatë hetimeve dhe burgjeve pas vitit 1981. Në fakt, pas rënies së Rankoviqit, shqiptarët e Kosovës u ndjen më të lirë, dhe si rrjedhojë, shpërthyen demonstratat e vitit 1968 për flamur e univerzitet dhe në këto rrethana fituam edhe kushtetutën e vitit 1974 e cila ishte shumë më e avancuar në kuptimin juridik dhe politik. Pas rënies së Rankoviqit, megjithate, filloi një frymë e re, por koha e dëshmoi se nuk ishte e mjaftueshme për synimet tona kombëtare. Në anën tjetër edhe pse Rankoviqi ra formalisht, rryma e tij politike çdo ditë e më shumë ringjallej dhe kjo kulmoi me Sllobodan Millosheviqin. Në vitin 1989 ai suprimoi edhe autonominë dhe kushtetetutën e vitit 1974. Në rrjedhë të kësaj dhune shpërthyen edhe luftërat brenda federatës jugosllave, si në Slloveni, Kroaci, Bosnje dhe së fundi gjatë vitit 1998/1999 në Kosovë.

SHABAN ÇUPI, HANI I ELEZIT

VITI I PUBLIKIMIT, KORRIK 2026

BOTIM ELEKTRONIK NË INTERNET ARCHIVE

Za internu upotrebu

Për përdorim intern

SKUPŠTINA OPŠTINE UROŠEVAC I KAÇANIK

Medjuopštinska državna komisija za utvrdjivanje deformacija, zloupotreba i preduzimanje mera na reorganizaciji u službi državne bezbednosti

KUVENDI I KOMUNES FERIZAJ DHE KAÇANIK

Komisioni ndërkomunal shtetnor për konstatimin e deformimeve, keqpërdorimeve dhe marrjen e masave në riorganizimin në shërbimin e sigurimit shtetnor

I Z V E Š T A J

O RADU MEDJUOPŠTINSKE DRŽAVNE KOMISIJE ZA UTVRDJIVANJE DEFORMACIJA I PREDUZETIM MERAMA NA REORGANIZACIJI U SLUŽBI DRŽAVNE BEZBEDNOSTI

R A P O R T I

MBI PUNEN E KOMISIONIT NDERKOMUNAL SHTETNOR PER KONSTATIMIN E DEFORMIMEVE DHE MARRJEN E MASAVE NE RIORGANIZIMIN E SHERBIMIT NE SIGURIMIN SHTETNOR

Uroševac, marta 1967. god.

Ferizaj, mars 1967. vjeti.

FORMIMI, ORGANIZIMI DHE METODA E PUNES SE KOMISIONIT

Me rekomandimin e Komisionit Krahinor për riorganizimin e Shërbimit të sigurimit shtetnor dhe për shqyrtimin e deformimeve dhe keqpërdorimeve në punën e ktij shërbimi, Kuvendet e komuneve Ferizaj dhe Kaçanik formuen komisionin e përbashkët shtetnor. Me nji herë mbas formimit, komisioni ja filloi punës. Ky ka shqyrtue materijale voluminoze: parashtresa e flet-paraqitje numerike të qytetarve, raporte e proçese nga mbledhjet e organizatave shoqnore e politike dhe forumeve të tjera, proçese nga mbledhjet e pjestarve të SPM-e dokumentacionin dhe evidencen e Shërbimit të sigurimit shtetnor pranë Sekretarjatit në Ferizaj, dekllaratat e nëpunsave dhe funksionarve të Shërbimit të sigurimit shtetnor e tj. Pos ktyne asht ba kqyrje-shiqim mbi punën e Gjyqit komunal në Ferizaj.

Ky Komision qysh në fillim u ballafaque me materijale voluminoze të marruna prej Komisioneve partiake të KK LKS në Ferizaj dhe Kaçanik, flet-paraqitjet numerike të qytetarve mbi keqpërdorimet e lloj-llojshme dhe të randa të disa nëpunësve e organeve të sigurimit shtetnor në Krahinë, gjegjsisht sekretarjatit për punë të mbrendëshme në Ferizaj, si shërbim i përbashkët për komunet Ferizaj dhe Kaçanik. Me qëllim të nji pune sa ma efikase dhe sa ma të drejtë të orijentimit t'aktivitetit të vet, Komisioni qysh në mbledhjen e tij të parë i ka shique materialet, i ka shumëzue dhe rregullue simbas personave d.m.th. pjestarve të SPM-e, për të cilët kishin të ba ë materijalet. Në këtë mënyrë janë formue 52 landë për pjestarët e SPM-e në Ferizaj. Mbas gjithë kësaj për disa flet-paraqitje dhe tregime të qytetarve, të cilat flasin për keqpërdorimet e S Sh dhe pjestarve të tij, pjestarve të SPM-e Ferizaj, e të cilat nuk kanë qenë të qarta e konkrete, me qëllim që Komisioni të këtë pasqyrë të qartë mbi tanë atë mbi shka kanë shkrue qytetarët individë në dekllaratat e tyne dhe parashtresat e tyne. Komisioni organizoi shkuemjen në teren të antarve të Komisionit. Me këtë rast antarët e Komisionit kanë biseduo me qytetarë të ndershëm, këshilltarë të Kuvendit komunal, përfaqsues të shoqatave të Lidhjes socialiste, sekretarë të O Th të LKS, me qëllim që të sqarohen me përpikmëni disa gjana dhe komisioni të vijë deri në konstatime të sakta.

Në këtë rast ma së shumti asht shkuc në skjarimin me hollësi të disa gjanave nga koha e akcionit për mbledhjen e armëve në vjetin 1956.

Mbassi në fushëveprimtarin e punës së këtij Komisioni binte edhe çashtja e riorganizimit të Shërbimit të S Sh.e mbrenda Komisionit nuk ishte formue nënkomision për ato qëllime, për këtë i tanë Komisioni në bashkëpunim me forumet tjera shoqnore politike të Krahines dhe komunave Ferizaj e Kaçanik asht angazhue me seriozitetin ma të madh për zgjidhjen e ktij problemi.

Komisioni i ka mbajt gjithsejt 10 mbledhje, dhe çashtjet të cilat kanë dominue për gjatë kohës së punës së ktij Komisioni kryesisht kanë të bajnë me:

-shqyrtimin e materijaleve dhe fakteve mbi deformimet, keqpërdorimet, si dhe kryemjen e veprave penale të pjestarve të Shërbimit të sigurimit shtetnor dhe shërbimeve tjera t'organove të punëve të mbrendëshme;

- mandoj për projektin e ligjit themelor mbi Shërbimin e punëve të mbrendëshme;

- projekt ligjin mbi organizimin dhe detyrat e Shërbimit të sigurimit shtetnor, si dhe me shumë çashtje të tjera.

Gjatë ksaj pune Komisioni ka pasë ndihmë bukur të madhe nga ana e antarve të Komisionit shtetnor të Krahinës, të cilët kanë marrë pjesë në disa mbledhje të ktij Komisioni dhe kanë dhanë sugjestione të dobishme për vlersim të drejtë dhe konstatim po të drejtë të disa rasteve të veçanta.

II

DEFORMIMET, SISTEMI I PUNES DHE ORGANIZIMI I SHERBIMIT

Mbas shqyrtimit të materijaleve ekzistuese, shumë parashtresave dhe flet-paraqitjeve të qytetarve, deklaratave dhe bamunive të tjera të pa kontestueshme, ky Komision ka konstatue se vlersimet e Plenumit të IV të KQ LKJ dhe Plenumit të VI të LKS si dhe Plenumit të VII të K K të LKS për Kosovë e Metohi mbi keqpërdorimet dhe deformimet në punën e Shërbimit të sigurimit shtetnor plotsisht kanë të bajnë edhe në veprimtarin e ktij Shërbimi në teritorin e komunave Ferizaj dhe Kaçanik.

Edhe Shërbimin e sigurimit shtetnor në këtë teritor e ka karakterizue: mos besimi i menduem ndaj pjestarve të kombësisë shqiptare, mbyllja byrokratike, mbrapambetje e koncepcioneve politike, mbyllja kundrejt trupave përfaqsuese dhe forumeve politike, ngarkimi me orvatjet për të përcjellë dhe vlersue jetën e tanë shoqnore e politike dhe reagimin e opinionit publik në këtë teritor, mbjellja e frigës tek qytetarët, sjelljet jo ligjore dhe jo humane, mbështetja në punën e vet në disa njerëz me kualitete të dobta morale e politike, realizimi i dobinave-fitimeve pasunore me të pa drejtë e tj. numuri i madh i flet-paraqitjeve dhe parashtresave të qytetarve, si dhe të pjestarve të SPM-e dhe milicisë e kto gjithsejt 134, prej të cilave 119 janë paraqitë nga ana e qytetarve, kurse 15 janë paraqitë nga ana e SPM-e dhe milicisë. Prej flet-paraqitjeve të përgjithshme vetëm 2 sosh janë anonime, kurse të tjerat janë të gjitha me nënshkrimin e paraqitësvet. Nga kjo shifet se qytetarët mbas Plenumit të IV të KQ LKJ po i paraqesin haptas padrejtësitë dhe keqpërdorimet të cilat i kanë krye pjestarët e Shërbimit të sigurimit shtetnor në këtë teritor.

Numuri ma i madh i flet-paraqitjeve dhe parashtresave të qytetarve kanë ardhë nga rajoni i qytetit Ferizaj (27), katundi Kamen Gllavë (10), Mirosalë (9), Shtimje (8), Kacanik (6), Sopotnicë (5), kurse numuri tjetër i flet-paraqitjeve dhe parashtresave kanë ardhë prej pjesëve tjera në teritorin e ktyne dy komunave, kështu edhe prej vendeve të teritoreve të komunave tjera, ku përpara kanë punue pjestarët e Shërbimit të sigurimit shtetnor, shërbimit për zhdukjen e kriminalitetit dhe milicis. Flet-paraqitjet

dhe parashtresat e qytetarve kanë të bajnë në sjellje të ndryshme të pa ligjëshme të individve të milicie, Shërbimit për zbukjen e kriminalitetit e ma së shumti në Shërbimin e sigurimit shtetnor, ku po theksohen raste të randa të cënimit-shkeljes së të drejtave të qytetarve dhe kushtetuese, maltretime dhe mundime fizike deri në damtime të randa trupore dhe vdekje të qytetarve. Ka raste ku disa keqbamje i kanë organizuc udhëhoqësit e Shërbimit, nëpërmjet të puntorve operativë, kurse tash atë po e heshtin ose bilo edhe po e mohojnë. Për disa keqbamje udhëheqsit e ktij shërbimi po rrij në të mbyllun, kurse fajet janë të sigurta.

Numurin ma të madh të flet-paraqitjeve dhe parashtresave i kanë paraqitë pjestarët e kombësis shqiptare, e ka edhe njifar numuri sosh të paraqituna edhe nga ana e kombësis sërbe. Struktra e ktyne flet-paraqitjeve në lidhje me paraqitësit, e paraqitjeve të atyne që kanë krye keqpërdorime dhe llojet e keqpërdorimeve asht si vijon:

1. Paraqitsit e fle-paraqitjeve të cilët paraqiten si të damtuem:

- shqiptarë	125
- sërbë	9

2. Pjestarë të Shërbimit të punëve të mbrendëshme, të cilët paraqiten si bamës të keqpërdorimeve:

- Shqiptar	34%
- Sërb	51,9%
- Malazez	13,5%

Flet-paraqitjet dhe parashtresat përmbajnë llojë të ndryshme të keqpërdorimeve të pjestarve individë të Shërbimit të sigurimit dhe tjerve, prej rrahjes, maltretimit, lëndimeve të randa trupore, keqpërdorimo materijale, lëndimeve të randa trupore të kualifikuome ma vdekje e tj.

Pjesa ma e madhe e parashtresave të marruna përmbajnë shënime të sakta, të keqpërdorimeve të randa të individëve nga Shërbimi i sigurimit shtetnor, shërbimit për zhdukjen e kriminalitetit dhe milicisë, që janë vërtetue me shënimet dhe dokumentacionin e burimeve tjera, e nji pjesë të keqpërdorimeve dhe keqbamjeve i kanë vërtetue edhe vet pjestarët e Shërbimit në dekllaratat e veta.

Paraqitësit e flet-paraqitjeve dhe parashtresave kryesisht kanë qenë objektivë dhe konkret, që prap nuk don të thotë se nuk ka pasë asi të pa baza e tendencioze. Keqbamjet qytetarët ua kanë përshkrue individve, të cilët konsiderohen përgegjsa, e i kanë dënue në radhë të parë edhe deformimet e Shërbimit dhe pjellë e tij

Edhe në këtë teritor Shërbimi i sigurimit ka ndikue në tanë zhvillimin shoqnor. Nuk i asht përshtatë rrugëve dhe zhvillimit të sistemit demokratik vetqeverisës, ai edhe në këtë qark ka ardhë dori në mos mbajtjen e hapit me sistemin dhe asht ba pengesa e tij.

Asht e domosdoshme me theksu edhe atë se qytetarët në flet-paraqitjet e tyne dhe në diskutimet e tyne nuk kanë potencue sjelljet e organeve të sigurimit shtetnor para vjetit 1956. dhe kohën e akcionit për mbledhjen e armëvet në masë aq të madhe.

Komisioni nuk i ka shqyrtue rasat dhe sjelljet e organeve të sigurimit shtetnor të cilat kanë qenë të lidhuna me llogaritjen kundër elementave kontra revolucionit - ballistave, çetnikëve dhe jataqeve të tyne, informbyroistave, shpijunave të ndryshëm, si dhe në lidhje me masat e ndryshme (nacionalizimit, syprinimit të tregtis private, grumbullimeve të ndryshme, krijimit-formimit të kooperativave të katundarve) e tjera të ngjajshme. Mbas luftës kur kanë qenë marrë kto masa Shërbimi i sigurimit shtetnor ka pasë suksese të dukshme, të cilat i ka mbërrijt bashkë me fuqit tjera shoqnore në këtë teritor, por krejt shka ka punue atëhere nuk mund të justifikohet për keqpërdorimet në punën e tij të ma vonshme.

Domethanë komisioni ka marë në shqyrtim vlersimin e rasteve të cilët kryesisht kanë të bajnë në kohën e 10 vjetëve të fundit e posaçërisht ka marë në shqyrtim dhe vlersim rastet që kanë të bajnë me vjetet e ma parshëm.

Prej materijalit që komisioni ka pasun në dispozicion shifet që keq përdorimet nga ana e nëpunsave të shërbimit të sigurimit shtetnor, janë ba në të shumtën në dam të qytetarve të kombësisë shqiptar, e kjo nuk don të thotë që nuk ka pas keq përdorime të bame në dam të kombësis[illegible] Sërbe, por se në vëllim ma të vogël.

Popullsija shqiptare, si pakicë nacionale, ashtë konsiderue si e pa besushme, kanë vërtetue se shqiptarët, me vet ate që janë pakicë nacionale, ma shumë janë të mbështetun vendit amë, dhe mund lehtë të vihen në shërbim të shërbimit informativ të të hujve. Konstatime të tilla kanë krijue kushte për keqpërdorime të ndryshme në dam të kombësis shqiptare.

Në raportet që i janë dërgue Sekretarijatit Krahinor për punë të mbrendëshme nga ana e seksionit sekretarijatit punëve të mbrendëshme në Ferizaj, shifet që disa konstatime në raporte janë kaq jo realë në të njajtit ashtë kallzue jo realë mosdisponimi politik i popullsis shqiptare në këtë teritori, dhe se organi sigurimit shtetnor ka pas mosbesim total ndaj puntorve të [illegible] kombësis shqiptare, si dhe mos besim në inteligjencën jetër shqiptare. Në raporte zakonisht ashtë shkrue gjithshka e e shka mos, tue fillue prej formës prapagandës anmiqsore, e me anë të kriminalitetit ekonomik, shfaqje antisocialiste, deri në përcjellen e zgjedhjeve, vlersimi i agjnimit të ramazanit e kështu të ngajshme.

Ashtë karakteritik po ashtu që në mënyra të caktueme në përmjet të raporteve dhe informatave shpesh herë ashtë potencue problemi shpërnguljes së popullatës Sërbe nga kjo teritori për shkak të shtërngesës nga ana e kombësis shqiptare. Po ashtu ashtë interesant me cek se me anë të raporteve kanë kallzue shënbuj të ndikimit anmiqsor nga ana e kombësis shqiptare, për këtë paraqitet pytja se sa në këtë drejtim kanë qënë objektivë? Ka shumë raste që ksaj

kombësije dhe marrëdhanieve të një ndaj socijalizmit ti përshkruhe mvishen karakteristika të njifar elementi jo lojal. Për shembull do të marrim një citat prej një raporti gjashtëmujor nga vjeti 1956, dërgue nga ana e degës së SPM-së Ferizaj Sekretarjatit Krahinor për punë të mbrendëshme në Prishtinë, ku pos tjerash mbi kombësinë shqiptare thuhet: "Mbassi pakica e kombësis shqiptare asht kompakte, e cila përfaqson shumicën e popullsis në këtë teritor për gjatë dy deri tri vitet e fundit tek ajo po depërton propoganda e dyfishtë, gjegjsisht po ndihen dy rryma të veprimtaris anmiqsore. Posaçërisht e fortë asht propaganda nacionaliste të cilën po e ngjallin komitetet e ndryshme nacionaliste e balliste nga perëndimi dh po i japin asaj vijën e punës anmiqsore. Këtë vijë propagandistike dhe anmiqsore të punës në këtë teritor në radhë të parë po e përvetsojnë dhe zbatojnë intelektualët, posaçërisht kuadri arsimor shqiptar, elementet profashistë dhe iredentistë".

Prej disa prej materijaleve të ktij shërbimi shifet se i njajti nuk ka pasë besim as edhe në funkcionarët e komunes dhe funkcionarët e organizatave shoqnore-politike. Në raporte disa prej funkcionarëvet janë tregue në veshje ma të zezë, dhe asht shkue n'atë drejtim që të njajtit të kompromentohen. Për illustrim po sjellim shembull titullin e një raporti të Degës së SPM-së të Ferizajt, i cili i asht dërgue Sekretarjatit për punë të mbrendëshme të Krahinës mbas vjetit 1958. i cili thotë: " Raporti mbi lidhjet, protekcionet dhe keqpërdorimet e personave në vende udhëheqëse të punës". Mirpo,kur lexohet përmbajtja e ktij raporti nuk asht fjala mbi kurrfar keqpërdorimesh të personave në vende udhëheqëse të punës e pozitwa në komunë dhe organizata shoqnore e politike në këtë teritor, por se ky shërbim dhe njerzit të cilët qëndronin në ballë të tij kanë pun që pa kurrafar arsye të kompromitohen në shumicën e forumeve dhe organeve e organizatave puntorët shoqnoro-politik të ktij teritori.

Kto konstatime dhe konstatimet tjera ksi soj t'organeve të sigurimit shtetnor e të cilat janë numerike, flasin në mënyrë jo reale mbi gjendjen dhe rrethanat në këtë teritor, e aq ma fort kur asht fjala për konstatimet lidhun me kombësin shqiptare, dhe si të tilla tregojnë në deformime të thella politike dhe ideore të ktij Shërbimi.

Edhe në këtë teritor Shërbimi i sigurimit shtetnor ka insistuo për të krijuo kontrollin total, dhe në këtë qëllim, simbas vijës së sigurimit shtetnor, janë ba të dyshimtë nji numur i madh qytetarësh, janë vu nën kontrollë, dhe kështu janë formue gjithsejt 2.150 dosije, por se të bajnë vetëm me kuptim negativ. Prej numurit të përgjithshëm të dosjeve të formuome 1455 kanë të bajnë me pjestarët e kombësis shqiptare, kurse 695 në pjestarët e kombësis sërbe. Dosje janë mbajtë edhe për puntorë shoqnorë-politikë antarë të komitetit, këshilltarë, funkcionerë t'organizatave shoqnore e politike, antarë të komiteteve të sipërmarrjeve të LKS, udhëheqës të organeve t'administratës e tj. dhe se në kohën prej vjetit 1960. deri në vjetin 1966. në Shërbimin e sigurimit shtetnor janë rregjistruo në këtë kuptim të tillë negativ 77, prej të cilve për pjestarë të kombësis shqiptare 48, pjestarë të kombësis sërbe e malazeze 29. Për personatë e sipërmendun nëpërmjet të evidences së Shërbimit për zhdukjen e kriminalitetit janë kalue gjithsejt 157 persona prej të cilvet 87 të kombësis shqiptare, e 70 për pjestarë të kombësis sërbe dhe malazeze.

Përpos dosijeve personale në SPM-e të Ferizajt janë regjistruo nëpërmjet landëve të ndryshme në grupe, mandej në evidencat e shërbimit për zhdukjen e kriminalitetit për kriminal klasik dhe ekonomik ma se 12.000.- persona.

Ky shërbim ka krye cenzurë të pa lejueshme masovike të letrave dhe dërgesave tjera, të cilat u kanë ardhë qytatarve tanë nga jashtë, si dhe t'atyne të cilat janë dërgue jasht shtetit nga ana e qytetarve tanë. Kjo cenzurë e letrave dhe dërgesave

tjera, ka shkuo në nji gjanci aq të madhe, sa që janë kontrolluo letrat dhe dërgesat e qytetarve të ndershëm të ktij teritori, o bile dhe t'antarve të komiteteve komunale.

Në këtë teritor Shërbimi i sigurimit shtetnor ka pasë praktikë që deri në kto informata dhe shënime të vijë nëpërmjet rrjetës së bashkëpuntorve. Kjo far rrjete ka ekzistuo pothuejse në të gjitha katundet, rajonet e qytetit, organizatat ekonomike, themelatat arsimore, shëndetsore dhe themelatat tjera. Mirpo, në luftë kundër anmikut të klasës dhe pikpamjeve e formave të tjera të veprimtaris së organizueme ilegale anmiqsore, tue mos përjashtue rolin e rrjetës së bashkëpuntorve, nuk asht dashtë me ju shmangë e kaluo për anash fuqive subjektive në këtë teritor. Lidhja e komunistave dhe vetdija patriotike e qytetarve duhej të ishte mbështettja kryesore e shërbimit në luftë kundër të gjitha formave të veprimtarive anmiqsore, e jo vetëm e rrjetës së bashkëpuntorve.

Asht vu re se personat të cilët Shërbimi i ka organizue për bashkëpuntorë, nji pjesë e mirë e tyne janë të kompromituem në popull, persona të cilët kanë qenë bile dhe të dënuem dhe persona të tjerë me të meta, të cilët janë të prirun-anuem malversimeve dhe intrigave të ndryshme. Ka pasë raste ku ksi persona të kompromotuem ose bashkëpuntorë të ecin me disa nga nëpunësit e Shërbimit të S. Sh. e kta nëpër kafene e vende tjera.dhe në këtë mënyrë janë ba në njifar dore pushtet apo si pushtet, posaçërisht në katund, ku janë ngritë bile edhe përmbi organizaten e Lidhjes së komunistave. Kjo shtresë e tillë njerzish në syt[illegible] e qytetarvet janë trajtue si shtresë e keqe dhe të njajtit kanë qenë barrë e randë e qytetarve të ndershëm. Ka pasë raste që edhe qytetarët e ndershëm për shkak të interyenimeve pale se qysh të ktyne personave ksi soj të mos munden me realizue shumë të drejta të tyne, dhe kështu personat e tillë të cilët në mënyrë të caktuome kanë bashkë punue me Shërbimin e S.Sh. kanë gëzue privilegje të veçanta dhe dobina të veçanta. Organet e sigurimit i kanë shfrytëzue kta persona për krijimin e intrigave të ndryshme kundër qytetarvet të ndershëm, e bile edhe kundër antarve të Lidhjes së komunistave.

Mund të thuhet plotsisht se të gjitha vlerësimet e Shërbimit të S.Sh. janë bazuar edhe në këtë teritor mbi gjendjen dhe rrethanat dhe tanë jetën shoqnore e politike në shënimet të cilat ktij Shërbimi ja ka dhanë rrjeta e bashkëpunëtorvet.

Edhe politika e kuadrove në Shërbimin e S.Sh., Shërbimin për zhdukjen e kriminalitetit dhe milicis ka pas qenë e pa drejtë në këtë teritor, si në pikpamje të përbamjes kombëtare ashtu edhe në pikpamje të strukturës kualifikuese. Në shërbimin e sigurimit shtetnor ka pasë numur të vogël të pjestarve të kombësis shqiptare, tue marrë parasysh se në këtë teritor jetojnë 70% pjestar të ksaj kombësije. Numur i vogël i pjestarve të kombësis shqiptare ka qenë edhe në shërbimet tjera të Sekretarjatit të punëve të mbrendeshme.

Ekzistimin e gjendjes së tillë në politiken e kuadrove, pos tjerash, e vërtetojnë edhe shënimet vijuese:

- t'inkuadruem:

Në shërbimin e sigurimit shtetnor Shqiptar 25%, Sërb e Malazez 75%.

Në shërbimin e zhdukjes së kriminalitetit: Shqiptar 30% Sërb e Malazez 70%.

Në Shërbimin e milicis: Shqiptarë 40%, Sërb e Malazez 60%.

- Struktura kualifikuese:

Në Shërbimin e sigurimit shtetnor: me pregatitje fakulteti të njoftun 17%, me të naltë 8%, me të mesme 42%, me t'ulët 33%.

Në shërbimin për zhdukjen e kriminalitetit: me pregatitje fakulteti të njoftun 8%, të naltë 8%, të mesme 38% dhe t'ulët 46%.

Në Shërbimin e milicis: me të të mesme 2%, me t'ulët 98%.

Prej shënimeve të sipërme shifet se edhe struktura kualifikuese ka qenë e dobët në kto organe - shërbime të Sekretarjatit të punëve të mbrendëshme në përgjithësi, kështu që shumica e nëpunsave kanë qenë me pregatitje t'ulët profesionale, dishka me pregatitje të mesme, kurse nji numur pa randësi me pregatitje të naltë e me fakultet (e kta me pregatitje profesionale të njoftun të fakultetit).

Për sa i përket veprimtaris fraksioniste në këté Shërbim në kët teritor edhe ajo ka ekzistue e cila shifet në dhanien e vlersimeve joreale mbi gjendjen politike në kët teritor, të cilat plotsisht nuk janë përputhë me vlersimet e forumeve politike dhe kolegjiumeve përfaqsuese. Kto vlersime i kanë dhanë udhëheqsit e Shërbimit të sigurimit shtetnor dhe të njajtat i kanë dërgue funkcionerve Republikanë e të Krahines të sigurimit shtetnor, e kto pa dijenin e kolegjiumeve dhe forumeve përfaqsuese e politike në kët teritor.

III

QËLLIMI, METODA DHE PASOJAT E AKCIONIT PËR MBLEDHJEN E ARMËVE

Keqpërdorimet ma të randa dhe ma drastike mbi qytetarë janë krye gjatë kohës së akcionit për mbledhjen e armëve, i cili në terenin tonë asht krye në kohën prej 20. kallnor deri me 20. mars 1956. Me kët akcion janë përfshi 88 katunde prej gjithsejt 116 në teritorin e komunave të tashme Ferizaj e Kaçanik. Simbas dokumantacionit i cili ekziston në organet e punëve të mbrendëshme, akcioni asht krye për atë, se gjoja, sasi e madhe e armëve ka pas qenë fshehë tek qytetarët, se kto armë paraqisnin rrezik potencial për marrëdhanie jo lejale ndaj bashkësis s'onë. Mirpo, akcioni dhe masat kanë pasë për qëllim për të futë frikë tek qytetarët, për ti ju paksue vlefta e rolit të fuqive tjera shoqnore, kurse gjatë akcionit organet e sigurimit shpreheshin në mënyrë ma të volitshme në pikpamje të suksesit të ktij akcioni në kët teren, tue e tregue si shumë pozitive dhe të dobishme. Mbi atë flasin disa vlersime dhe raporte të Deges së atëhershme të SPM-e. Në buletin mujor për muejin fror 1956. në mes tjerash asht dhanë edhe nji vlersim i tillë: "Simbas mendimit tonë ky akcion për mbledhjen e armëve asht shprehë pozitivisht dhe ka veprue drejt në disa probleme në teren. Prej fillimit t'akcionit deri më sot, nuk kemi pas asnji rast të çfaqjes së kriminalitetit sikurse janë kriminaliteti n'ekonomi, hakmarrje gjaku, rrahje, vjedhje e tj. të ngjajshme si edhe në elemente anmiqsore ka pasë efekt politik të cilët për tash kanë ra në heshtje. Njerzit e ndershëm në terenin tonë në kët akcion po shofin si në nji gja shumë pozitive dhe po komentojnë në mes vedi, dhe po flasin se pushka askujt nuk i ka pru fat, se si

pushka asht e keqja ma e madhe për ne në Kosmet, sepse janë ba hakmarrje gjaku të ndryshme, plaçkitje, rahje e tjera të ngjajshme, dhe se gjithmonë njerzit kanë vuejt dhe vra".

Pa marrë parasysh në motive me të cilët justifikohej akcioni për mbledhjen e armëve dhe në anën e tij "shumë pozitive", dhunimi i cili asht ba përmbi popullsin, metodat dhe masat të cilat janë zbatue-përdorë paraqesin shkeljen ma brutale të së drejtës së qytetarve dhe kushtetuese si dhe lëndimin ma të randë të personalitetit njerzor, dinjitetit të njeriut, ndjenjave dhe humanizmit njerzor. Pjestarvet të Shërbimit u kanë pas qenë durt e shlirshme në pikpamje të zgjedhjes, së metodave dhe mjeteve për ta llogaritë me qytetarët e pafajshëm.

Simbas flet-paraqitjeve të qytetarve të paraqitunu Komisionit, diskutimeve në tubime të ndryshme dhe dekllaratave të disa prej pjestarëvet të Shërbimit-pjesmarrës në këtë akcion, shamjet, ramjet me shuplakë, rrahjet, grahjes nëpër borë dhe lagëjes me ujë në ditët e dimnit, mbajtja në lokale të ftohta, gjymtimi (sakatimi) fizik e bile edhe mbytja -vdekja - kanë qenë metodat dhe masat gjatë zbatimit t'akcionit. Krejt kto na çojnë në përfundim se qëllimi i akcionit ka qenë hakmarrja dhe futja e frikës tek qytetarët. Të gjitha kto metoda të mundimit të cilat janë zbatue, e të cilat janë të shkrueme në flet-paraqitjet dhe të cilat janë vu në pah në tubime të ndryshme mbas Plenumit të IV të KQ LKJ, jo vetëm se tejkalojnë të gjitha ndjenjat dhe normat morale njerzore në sjelljo kundrejt njeriut, por lanë përshtypje të nji atmosfere shumë vuejtjeje dhe shqetsimi. Për zbatim masovik të përdorimit të masave drastike dhe metodave të mundimit posaçërisht karakteristike janë disa katunde sikurse janë: Mirosala, K. Gllava, Baliqi, Vata, Sopotnica, vet Kacaniku e tj., ku po thuejse nuk ka pasë shtëpi që ndonjeni prej mashkujve të rritun të mos jet nënshtrue rrahjeve, e bile kanë vuejt edhe antarët e shtëpisë-familjeve. Në Mirosalë janë thirrë edhe gratë për të kërkue armë prej tyne, e kur fëmijt e shkollës kanë vrapue kah prindët e tyne të cilët gjindeshin në shkollë ose sillesshin zbathun nëpër borë, janë përzanë ose largue me shtimje prej automatikëve përmbi krye të tyne, ose në Komo Gllavë kur gruesja e ka pa burrin e vet s si po e rrahin në mënyrë të pa mëshirshme, asht tronditë prej pamjes së tmerrshme,

dhe asht qmendë dhe mbas disa muejve edhe ka vdekë në Spitalin e Shkupit. Krejt kjo tregon se nga ana e disa personave, gjegjsisht pjestarve të ktij Shërbimi ka pasë jo vetëm tejkalim t'autorizimeve poer edhe vet knaqësi.

Asht interesant me përmendë se n'elaboratin e akcionit për mbledhjen e armëve i cili gjindet në SPM-e në Ferizaj, e cili përmban raportet e analizat e zbatimit të ktij akcioni, paraqiten vlersimet e shënimet të cilat nuk përputhen me gjendjen e vërtetë dhe të cilat nuk janë reale e objektive. Kështu për shembull, ka raste që për disa katunde asht shkrue, se të gjithë qytetarët e katundit përkatës janë anmiq, se i tanë katundi asht i njoftun për shkak të bashkëpunimit me okupatorin e tjera të ngjajshme.

Në këtë elaborat janë dhanë shënime se gjatë akcionit represalijet janë zbatue përmbi 268 persona, e në se do të kemi parasysh se akcioni i ka përfshi 88 katunde, atëherë duket se në sedilin katund janë rrahë mesatarisht rreth 3 persona. Mirpo, Komisioni konsideron se shënimet as për së afërmi nuk janë të sakta, sepse gjithsesi me rrahje janë përfshi shumë ma tepër njerëz. Për shembull, në katundin Mirosalë ku janë rrahë e maltretue 104 qytetarë, në raport thuhet se represaljet e rrahjet janë zbatue në 16 persona. Ose, për qytetin e Ferizajt, në raport qendron shënimi se janë rrahë 8 persona, kurse në listën e të rrahunve e cila asht gjet të në stacionin e milicis në Ferizaj figurojnë 20 të rrahun e kta e on për emën. Simbas ndonji llogarije të vrazhdët (asht e pa mundun me dhanë shënime precize), Komisioni konsideron se me rrahje e maltretime janë përfshi ma se 500 qytetarë në teritorin e ktyne dy komunave.

Asht karakteristike, se në kto materijale gjithashtu fare nuk përmenden rastet ku represalijet dhe torturat e ndryshme të kenë lanë pasoja tek njerzit, me gjithse Shërbimi në disa rasa të gjymtimit fizik dhe mbytjes-vdekjes ka pase qenë e njoftun. Bile edhe për rast vrasjeje për gjatë kohë së rrahjes në katundin Sopotnicë - K K Kaçanik, jo vetëm se ky rast nuk asht regjistrue por ky person as që figuron në listën e të rrahunvet, por vetëm thuhet se proj tij asht marrë nji pushkë.

Në flet-paraqitjet e tyne qytetarët i kanë paraqitë 7 raste vdekjesh për gjatë kohës së ktij akcioni dhe 12 raste të gjymtimit fizik.

Tek këto raste Komisioni ka pasë ma së shumti vështirsi rreth vërtetimit të saktësis së flet-paraqitjeve të cilat kanë të bajnë me rastet e vdekjeve. Asht vështirë me konstatue se a thue vdekja asht ba si rrjedhim i masave n'akcion për mbledhjen e armëve tek ato raste ku vdekja asht ba disa vjet mbas akcionit. Gjithashtu tash po paraqiten vështirsina në konstatimin se cili individ asht përgjegjes për rastin e paraqitun të vdekjes, gjegjsisht se cili do të mundej me u marrë në konsiderim për përgjegjsi. Por, me gjith atë Komisioni mbas shqyrtimit në pikpamje të saktësis për disa rasa ka mbledh shënime dhe materijal dhe i ka marrë masat përkatse që kto raste tu dorzohen organeve kompetente, mbi të cilat ma vonë do të bahet fjalë.

Ky akcion kryesisht ka qenë drejtue ndaj qytetarve të kombësis shqiptare, me gjithse me atë nuk janë kapërcye-evitue Sërbët e Malazezët. Me ksi far qëllimi dho për shkak të masave drastike dhe metodave, ai ka pasë shprehje për nxitje të shovenizmit në mes popujve, futjes së frikës dhe mos besimit në mes tyne dhe shumë pasojave tjera politike. Ai gjithashtu ka kontribue për tu forcue tashma procesi i filluem për shpërngulje në Turqi. Gjithashtu në atë kohë filloj shpërngulja e hovëshme për Maqedoni, ku pasojat për mbledhjen e armëve ishin ma të vogla. Gjithashtu ekzistonte nji far të kuptuemi se prej Maqedonis asht ma lehtë me u shpërngulë për Turqi, tue marrë parasysh se ktu asht thanë se popullsija e ktushme shqiptare nuk ka të drejtë për tu shpërngulë për Turqi.

Akcioni për mbledhjen e armëve asht kryer n'atë mënyrë që në inicijativen e organeve të punëve të mbrendëshme së pari janë mbajtë mbledhje me aktivin politik, e ku asht theksue se organet po mbledhin armët të cilat gjinden ilegalisht te qytetarët. Me nji herë mandej kanë fillue organet e punëve të mbrendëshme, të cilët janë marrë vesh me vijen e tyne dhe për tanë akcionin të cilin e kanë zbatue pa marrëveshje me forumet e udhëheqsit e organizatave

shoqnoro-politike. Roli i aktivistave politikë qe sjellë kryesisht në spjegimin e nevojes se armët duhet pa tjetër të dorzohen, për ndrysho ata nuk kanë pasë me përcjellë akcionin në teren, as që kanë qenë njoftue mbi volumin e keqpërdorimeve në këtë akcion. Bile në mënyrë shqiptuese ishte thanë nga ana e organeve të SPM-e se askush prej faktorve politik nuk ka të drejtë me intervenue, me ba vrejtje e tj. Me qenë se ka pasë raste reagimi e intervenimi nga ana e aktivistave - individ, të cilët kanë tentue me ba vrejtje se nji masë e tillë nuk asht në pajtim me sistemin tonë socijalist e marrëdhanieve shoqnore socialiste dhe se kjo mund të ketë si paso jë shkatrrimin e vllaznimit e bashkimit në mes popujve në Kosovë e Metohi, atëhere kjo nga ana e Shërbimit të sigurimit shtetnor asht çue si pengesë e akcionit dhe si oportunizëm, e ata individë janë proklamue "si interesantë për shërbimin e sigurimit shtetnor".

Asht e njoftun se në disa vende, ku janë angazhue fuqit objektive, ka pasë shumë ma pak keqpërdorime nga ana e pjestarve të Shërbimit të S Sh., dhe se janë arrijtë suksese shumë ma të mëdhaja në mblodhjen e armëve. Mirpo, në vendet ku fuqit objektive janë lanë m'anash dhe ku asht punue pa kontrollë dhe asht bë zbatue tortura, janë arrijtë rezultate ma të dobta. Duhet me cekë edhe disa momente karakteristike të cilat në nji far kuptimi kontribuojnë qitjen në dritë të thelbit e qëllimit të vet akcionit për mbledhjen e armëve:

- nga ana e organeve të sigurimit shtetnor asht ba ndikim në mjekë dhe institucione shëndetsore për të mos dhanë certifikata mbi lëndimet e qytetarvet me rastin e rrahjes e tjera të ngjajshme;

- asht ba ndikim në disa organe dhe themelata për të mos pranue ankesat e qytetarve në lidhje me sjelljet jo ligjore të disa prej nëpunsave të Shërbimit të S. Sh., e asht ba edhe kërcenim ndaj atyne të cilët janë përpjekë për tu ankue;

- nji numur i nëpunësve të SPM-e i cili ka kundërshtue metodat dhe masat të cilat i janë zbatue gjatë akcionit, asht marrë në përgjegjsi disciplinore, asht tërhek prej tereni si pasi e bile edhe transferue;

- mbas përfundimit t'akcionit asht paraqitë propozimi që të shpërblehen për përpjekje aktive 12 nëpunës dhe milicionerë me nji shpërblim në shumën prej 6-10-000.- din. të vjetër.

IV

LËNDIMET E RANDA KUNDER JETES DHE TRUPIT TE QYTETARVE

Komisioni ndërkomunal shtetnor për shqyrtimin e deformimeve të shërbimit të organeve të sigurimit shtetnor në Ferizaj, ka pasë në punën e vet flet-paraqitjet, lajmërimet e ankesat e qytetarve të cilët në parashtresat e tyne i kanë thanë-tregue keqpërdorimet e individve ose grupeve të njerzve nga sigurimi shtetnor, e të cilët në periudhen e vjetit 1956. n'akcionin e mbledhjes së armëve i kanë krye kto keqpërdorime.

Shërbimi i S. Sh. n'akcionin për mbledhjen e armëve e ka keqpërdorë pozitën e vet n'atë mënyrë që pa mëshirë dhe nën metoda shumë drastike i ka munduc e keqtrajtue njerzit në rajonin e ktyne dy komunave në të gjitha vendet ku organet e Shërbimit të sigurimit shtetnor kanë arrijt. Ka pasë aso shembujsh ku ata aty për aty në vend me rrahje kanë mbytë njeröz me gjithse tek të njajtit nuk kanë mujt me gjetë kurrfar arme. Shembull i tillë ka qenë në Sopotnicë. Në katundet Mirosalë, Baliq e Komo Gllavë ka pasë raste vdekjesh në të cilët vdekja asht ba mbas akcionit. Ksi far shembujsh-rasa ka pasë edhe në vende tjera ku ma parë kanë pase shërbye pjestarët e shërbimit të S. Sh.

Në këtë akcion pos asaj që nga ana e Shërbimit të S. Sh. njerzit në vend aty për aty janë mbytë ose vdekë dishka ma vonë mbas marrjes së pasojave akcioni ka lanë rrjedhime edhe n'atë mënyrë që shumë mbas akcionit kanë mbetë invalidë dhe të pa aftë për cfar do qoftë pune ekonomizimi. Ka pasë raste ku njerzit prej pasojave të marruna të rrahjes kanë mbetë defektë ose të sëmundë, n'atë mënyrë se atyne u janë damtue disa organe, sikurse janë damtimi i kambëve dhe organeve të ndryshme të tjera. Akcioni i ka lanë disa raste të invalidave të randë, të cilët janë përgjithsisht të pa aftë për jetë, gjegjsisht për kurrfar pune-ekonomizimi qoftë.

Komisioni nuk ka mujt mo pa se cili person randohet për vrasjet e nji nga njishme sepse në to përmendet shpesh herë grupi i njerzvet të sigurimit shtetnor, të cilët atëherë gjindeshin në teren.

Tue u nisë prej materijalit të cilin Komsioni në punën e vet e ka pasë në dispozicion, në disa raste edhe i ka provue në pikpamje të saktësis n'atë mënyrë se disa prej antarve të Komsionit kanë shkue në vend aty për aty nëpër katunde për ato deklarata, e në bazë të ksaj ka ardhë deri në konstatim randimi i disa njerzve të cilët atëhere kanë punue në shërbimin e S. Sht. e n'atë kohë kanë qenë udhëheqes e antarë asht ma bazë për ndjekje penale dhe në këtë drejtim ka paraqitë materijalin prokuroris kompetente për ndjekje për 5 raste vdekjeje.

Rastet e vdekjeve personat përgjegjes po i justifikojnë në mënyra të ndryshme, tue mshefë me mjeshtri tash e atëherë përgjegjsinë e tyne dhe veprimtarin e tyne të pa lejueshme n'atë mënyrë që socilit ja kanë ndalue për të mos i thanë askujt asgja mbi atë se shka ka punue Shërbimi i S. Sh. në këtë periudhë. Rastet e vdekjeve janë justifikue n'atë mënyrë: " A ke pushkë e për shkak se nuk ka dasht me e dorzue e kemi rrahë sepse tek ai kemi gjetë pushkën e mshefun", me gjithse me saktësi dihet se ato organe për të justifikue rastet e vdekjes vet i kanë vu armët e veta në lokalet e të vramit e mandej i kanë kërkue dhe gjetë.

Ndër disa rasa të veprave penale të cilat i kanë krye organet e sigurimit shtetnor në periudhen e mbledhjes së armëve nuk mund të ndërmerret kurrfar ndjekje për shkak të kohës së gjatë të kaluome dhe se ato vepra janë vjetrue. Kështu situata asht në shumë raste ku Komisioni nuk ka mujt me ndërmarrë asgja, por se ka vendos që paraqitësvet të lajmeve-njoftimeve, flet-paraqitjeve dhe ankesave tu përgjigjet për atë se ai nuk mund të ndërmarrë asgja kundër kryes vet, sepse simbas konstatimit të komisionit asht ba vjetrim apsolut.

Asht fakt se edhe tek shembujt drastikë të vrasjeve

Përveç asaj që organet e Shërbimit të S. Sht. i kanë keqtrajtuar, vra, marrë me të keq, i kanë lanë njerzit invalidë, ata edhe kanë ba presion në njerëzit tjerë të ndryshëm tue ju ndalue atyne për të mos i thanë askujt se shka kanë punue organet e sigurimit shtetnor n'akcionin për mbledhjen e armëve. Me gjithse saktësisht dihet se njerzit kanë qenë keqtrajtuar dhe rrahë, askush prej organeve të sigurimit shtetnor nuk asht marrë në përgjegjsi as kundër askujt nuk asht ngritë procedurë penale.

Prej flet-paraqitjeve të parashtrueme, lajmërimeve, dhe ankesave, Komisioni ka pa se kush po paraqet dhe kundër kujt dhe ka konstatue se kryesisht ata janë njerëz të cilët aktivisht kanë punue në Shërbimin e sigurimit shtetnor, kurse flet-paraqitjet e parashtresat tjera për të vdekunit i kanë paraqitë t'afërmit e tyne e të njoftunit e tyne, kurse për të damtuemit vet ata.

Secila parashtresë asht shqyrtue nga ana e komisionit dhe atje ku komisioni ka konsiderue se materijali asht i mjaftë për ngritjen e procedures penale kundër individve ose grupit, materijalin e ka kompletue dhe dergue organeve t'autorizueme për ndjekje. Materijalin ksi soj kryesisht Komisioni e ka kompletue për ata njerëz të Shërbimit të S. Sh. të cilët ngarkohen për vrasje.

Për raste vdekjesh dhe lëndime të randa trupore-damtime Komisioni ka shique materijalin dhe ka gjetë se për kto raste ngarkohen 15 persona, të cilët atëherë kanë qenë në Shërbimin e S.Sh

Personat të cilët ngarkohen për kto raste të randa kanë mundë me qenë fajtorë direkt ose indirekt për shuemjen e jetës ose damtimeve të randa trupore të njerzve.

Komisioni në bazë të materijalit të kqyrun nuk ka mujtë me ardhë deri në konstatime të sakta se cili asht kryesi direkt-fajtori tek të gjitha kto raste të njerzve të vdekun, dhe për këtë asht e domosdoshme që në procedurën e ma tejshme të konstatohet se cili individ asht përgjegjes për rastet e paraqituna dhe se cili asht ai që mban përgjegjsinë e tanë mbasi prej flet-paraqitjeve

damtimet e randa trupore prej kohës së bame të ktyne veprave e deri më sot ka kalue mjaft kohë dhe kjo i ka krijue vështirsina Komisionit për të thanë shka do qoftë në mënyrë ma të përpiktë mbi viktimat e aq ma parë kurse dihet me saktësi se organet e sigurimit shtetnor u kanë ndalue çdokujt për të thanë shkado qoftë mbi këto, që shërbimi publik shëndetsor të ofrojë ndihmë të damtuemvet, e për këto familjet e të damtuemvet dhe vet të damtuomit nuk posedojnë kurrfar konstatimi mjeksor si certifikatë mjeku ose çfar do tjetër dokument mbi damtimin trupor.

Komisionit i ka qenë shumë vështirë në rastet e vdekjeve, për të konstatue se a thu në mes të rrahjes dhe vdekjes së personit ekziston lidhja shkaktuese e aq ma parë tash kur kaq kohë ka kalue.

V

KEQPERDORIMET MATERIJALE DHE TE NATYRAVE TE NDRYSHME

Pos tjerash ka pasë edhe keqpërdorime të pozitës zyrtare me qëllim të mbbrrijtjes së përfitimeve materijale nga ana e disa prej pjestarve të shërbimit të punëve të mbrendëshme.

Keqpërddorimet e ktij lloji posaçërisht shifen në shpenzimin e pa ligjëshëm të mjeteve për destinime speciale, në shfrytzimin e atokerreve t'udhtimit për nevoja private, blemjen e automobilave me çmime t'ulta në licitacione të cilat kanë pasë karakter formal, në privilegje të ndryshme dhe favorizime të ndryshme, me rastin e blemjes së materijaleve ndërtimore për ndërtimin e shtëpive private, në shfrytzimin e mjeteve t.a q. "fondit të zi", në paraqitjen e llogarive fiktive t'udhtimit e tj. ksi soj. Për ilustrim po i sjellim disa shembuj vetëm: në SPM-e në Ferizaj janë gjetë 765.917.- din. të rij të holla të gatshme, të cilat i kanë takue të ashtu quejtunit "fond i zi". Kto mjete janë formue kryesisht nga shitja e gjanave të zanuna, inventarit të cregjistruem, dhe gjanave tjera, si dhe nga kompenzimi për punën e të burgosunvet. Kto mjete nuk janë inkasue-regjistrue askund as që ka ekzistue dokumentacion i rregullt. Me kto mjete janë ba shërbime të pa ligjë shme, tue filluc nga blemja e disa gjanave për nevoja të themelatës, dhe deri në keqpërdorim e shfrytzimin e tyne për banketa në Brezo-

vicë, ku vetëm me nji rast janë shpenzue 119.000.- dinarë të vjetër.

Mbajtja jo në rregull dhe përdorimi me landët, gjegjsisht me t a q. "korporadelikte" jep shenjë për dyshim që bile edhe fort ka pasë mundësi për keqpërdoeime të ndryshme me qëllim të mbrritjes së përfitimeve pasunore, sepse ishte praktikue që marrja-dhanija në dorzim të udhëheqjes së ksaj pune të bahet pa kurrfar proçesi. Komisioni nuk ka mujt me konstatue deri në detale udhëheqjen e punës me kto landë, gja që do ti mbetet për detyrë nji komisioni profesionale të konstatojë, por fakti asht se evidenca e mbajtun jo në rregull për shumë landë të shtrenjta dhe metale fisnore, të cmueshme. Me nji kqyrje përshit të punës së mbajtun me kto far sendesh, asht konstatue se nuk asht në rregull dokumentacioni për 58 copë orë të ndryshme xhepi, për disa duketë me nji vleftë prej 361.000.- din. të vjetër, se ka qenë nji orvatje të mshefjes së dy copave pesëlirash turke (prej ari) me nji vleftë prej 200.000.- din. të vjetër, e dihet se nji prej nëpunsave bile edhe ka përvetsue për vete dy duke të, të cilat ja ka dhanë peng personit të cilit i ka pas borxh nji shumë të hollash. Ka pasë raste ku me rastin e blemjes së tokës dhe banesave ndërtimore të banimit për nevoja t'emigrantave, asht shkue për tu ble nga nëpunsit të cilët punojnë n'organin e punëve të mbrendëshme ose tek t'afërtit e tyne, dhe për kët shtrohet pyetja se sa ka pasë realitet në vërtetimin e gjegjsisht ujdis në pikpamje të vleftës së ktyne pasunive.

VI

A THU KA PASE NDIKIM SHERBIMI I SIGURIMIT SHTETNOR NE GJYQE DHE PROKURORINA

Nuk mund të thuhet se Shërbimi i S. Sh. të mos ket pasë ndikue në gjyqe dhe prokurori, kompetente për kët rajon. Ka pasë raste ku organet e SPM-e të servizojnë me shënime të gabushme në lidhje me disa persona fajtorë në proceduren paraprak, që në proceduren paraprake ti detyrojnë për tregime ~~prej~~ fajtorvet ose në proces mbi marrjen në pyetje të shkruejnë të kundërten e asaj që ka pranue dhe ka deklarue fajtori. Ka rastis edhe kje që organet e SPM-e të kenë konstatue në proceset e tyne pranimin e të paditunit, por ksi far pranimi i padituni ta mohojë para gjyqit me rastin e shqyrtimit.

Për kryemjen e procedures paraprake për të gjitha veprat penale përveç atyne politike asht kompetent Shërbimi për zhdukëjan e kriminalitetit. Mirpo, simbas njifar rregulli të pa shkruem për disa vepra penale proceduren paraprake e ka marrë Shërbimi i S Sh, gja që e konsiderojmë të pa drejtë dhe të pa ligjëshme. Ksi soj ka qenë edhe me kryemjen e procedures paraprake kundër nëpunësve të Drejtoratit për punë të mbrojtjes popullore të Kuvendit komunal Ferizaj në vjetin 1966.

Prej kësaj del pyetja se si ka mujt prokurorija me lejue në këtë rast konkret që procedura penale paraprake të bahet nga Shërbimi i S Sh e jo shërbimi për zhdukjen e kriminalitetit.

Gjyqet dhe prokurorit për këtë rajon mund të thuhet se nuk i kanë shqyrtue në mënyrë të mjaftueshme në pikpamje kritike materijalet që janë servizue nga ana organeve të punëve të mbrendëshme sepse para së gjithash kanë pasë besim të madh n'ato organe dhe kanë ba hesap se ato i respektojnë dispozitat ligjore. Organi i Shërbimit të S Sh ka pasë ndikim edhe në politiken e kuadrove dhe në zgjedhjen e gjyqtarve dhe emnimin e prokurorëve dhe pra tamë kjo në mënyrë të caktueme ka pasë shprehje në punën e organeve të gjyqeve dhe prokurorive.

Ndikimi i organeve të SPM-e në të cilin ka qenë besimi asht pe ndie ne gjyqe e prokurorina në mënyrë direkte, sepse me saktësi se organet e SPM-e kanë qenë t'autorizuem për të ba proceduren paraprake gati ndër të gjitha veprat penale, se materijali vinte në prokurori, e në bazë të tij ngrihej edhe procedura penale kundër personave dhe të njajtin nxiroshin në gjyq.

VII

MASAT E MARRUNA PER NORMALIZIMIN E GJENDJES NE SHERBIMIN E S Sh.

Normalizimi i gjendjes në shërbimin e S Sh dhe shërbimet tjera t'organeve të punëve të mbrendëshme në këtë rajon, si dhe në taritorin e KAK e M, asht ba në frymën e qëndrimeve dhe konkluzave të Plenumit të IV të KQ LKJ, Plenumit të VI të KQ LKS dhe Plenumit VII të K K LKS. Në këtë plan janë marrë shumë masa.

Randësija dhe lloji i deformimeve në Shërbimin e sigurimit shtetnor kanë kërkue që me nji herë të fillohet ndrrimi i eprorve t'organeve të punëve të mbrendëshme, Në vend të funkcionerve të deritashëm të SPM-e janë emnue puntorë të spikatun shoqnorë politik, të cilët me ndihmën e gjithanëshme të kolegjiumeve përfaqsuese në Krahinë dhe komuna si dhe ndihmen e gjithanëshme të forumeve politi ke - shoqnore, qysh në fillim aktivisht janë përfshi në rregullimin e gjendjes n'organet e punëve të mbrendëshme dhe Shërbimin e sigurimit shtetnor.

Nji numur nëpunsish të Shërbimit të sigurimit shtetnor të cilët janë kompromitue tek qytetarët dhe në punën e deritashme të të cilvet janë ba shumë kritika për kryemjen e keqpërdorimeve e [illegible]i të cilët në mbledhjet e OS LK dhe Komitetit komunal të LKS janë shqiptue denime të rrepta dhe janë marrë masa partiake, janë largue prej detyrës.

Kundër puntorve përgjegjës të Shërbimit të S Sh asht dërgue materijali organeve kompetent për ngritjen e procedures penale e kjo mbas shqyrtimit të të gjitha parashtresave të qytetarve gjegjsisht mbas konstatimit të qëllimit të përshtatshëm të ngritjes së procedures.

Numuri i caktuem i puntorve të Shërbimit S Sh dhe shërbimeve tjera të cilët i kanë plotsue kushtet për pensionim, janë pensionue, e puntorët tjerë të cilvet vendi i punës u asht suprimu[illegible]me organizimin e sistemimin e ri do të inkuadrohen në punë n'organet dhe organizatat tjera mvarsisht prej përgatitjeve të tyne personale dhe aftësive të tjera.

Janë marrë disa masa në drejtim të përmirsimit së strukturës kualifikuese dhe përbamjes kombëtare në Shërbimin e S Sh dhe shërbimet tjera të SPM-e, kështu që tash janë në punë e punojnë në organet e SPM-e_____% pjestarë të kombësis shqiptare. Struktura kualifikuese dhe përbamja kombëtare e ktyne shërbimeve edhe në t'ardhëshmen do të përmirsohet.

Ky komision në nji mënyrë të caktueme dhe me të përshtatshme po i njofton qytetarët mbi ecunin dhe masat e marruna mbi flet-pa raqitjet e parashtrueme kundër pjestarve të Shërbimit të S Sh., dhe shërbimeve tjera të SPM-e. Simbas flet-paraqitjeve të cilat kanë të

bajnë me keqpërdorimet e natyrave materijale, Komisioni ka marrë qëndrim dhe ka vendosë që ato ti dërgohen organeve të punëve të mbrendëshme, të cilët me qëllim të shqyrtimit të rasave ksi soj dhe përgjegjsisë së individve do të formojnë komision të veçantë.

Komisioni konsideron, se në strukturen e masave tjera të cilat duhet me i ndërmarrë në planin e shëndoshjes së Shërbimit të sigurimit shtetnor, paraorientimit të tij në punë, si dhe për realizimin e kqyrjes së punës së tij nga ana e kolegjiumeve përfaqsuese konkludoi dhe propozon Kuvendeve të komunave Ferizaj dhe Kaçanik si vijon:

- që të gjitha fuqitë subjektive dhe qytetarët tu japin ndihmë të plotë dhe përkrahje organeve të punëve të mbrendëshme në kryemjen e detyrave të caktueme me ligj,

- që pjestarve zë milicisë popullore tu jepet përkrahja e plotë në mbajtjen e rendit publik dhe qetsis publike dhe në mbrojtjen e pasunis private e shoqnore si dhe jeten e qytetarve,

- që të zhduket sulmi frontal në të gjithë puntorët e Shërbimit të sigurimit shtetnor në përbamjen e të cilit kanë qenë puntorët të cilët me vetdije dhe në mënyrë të ndershme kanë punue, e gjithashtu duhet me luftue çdo tentativë të individve me qëllim që të paksohen vlefta e sukseseve të ktij Shërbimi, që posaçërisht në vitet e para mbas shlirimit të vendit tonë ka pasë në luftë kundër mbeturinave të bandave dhe anmiqve të tjerë të klasës, si dhe në zbulimin e veprimtarive ilegale anmiqosre t'organizueme dhe veprimtarive të shërbimeve të hueja informative,

- që Kuvendi i komunes Ferizaj dhe Kaçanik të bajnë përpjekje maksimale në drejtim të sigurimit të kushteve për punë efikase t'organeve të punëve të mbrendëshme,

- u rekomandohet Pleqsive për punë të mbrendëshme të Kuvendeve Komunale Ferizaj e Kaçanik që të aktivizohen sa ma shumë në realizimin e kqyrjes në punën e organeve komunale për punë të mbrendëshme dhe në përparimin e punëve të tyne.

Në rrjedhë të këtij Raporti dhe disi për ta plotësuar dhe kuptuar edhe më shumë aksionin e armëve të vitit 1956, dhunën dhe reprezaljet që bëheshin mbi shqiptarë, po e bartim edhe Poemën **Pushka amanet**, një material i botuar fshehurazi nga Organizata ilegale e asaj kohe që lexohej fshehurazi dhe përcillej dorë më dorë pas vitit 1981.

Ky material i fshehtë i ra në dorë edhe grupit tonë që vepronim ilegalisht. E rishtypëm me makinë mekanike shkrimi që e ruanim fshehurazi dhe e mbanim të fshehur në tokë. E nxjerrnim nga toka vetëm kur na duhej për të shtypur materiale ilegale. Ajo makinë shkrimi, edhe gjatë bastisjeve, edhe gjatë burgut nuk u zbulua kurrë. Origjinalin e fletave të shtypura e ruajmë edhe sot që të bëhet pjesë e muzeut kurdo që hapet në Han të Elezit.

Poema **Pushka amanet** i dedikohet pikërisht situatës së vitit 1956 dhe në një farë mënyre e plotëson ate që synojmë ta themi, sepse :

Atë vit kishte marrë

Dimër i vështirë

Nën borë e acar

Gjithçka kishte ngrirë.

Se ç`u bënin burrave

Ne atëherë se denim,

Por edhe ne e shihnim

Se si shkonin, nuk vinin.

Kështu atë dimër

E mplakte fshati im,

Mbështjellë me borë e mjegull

Me ankth e trishtim…

Atë vit kishte marrë
dimër i vështirë,
mën borë e acar
gjithqka kishte ngrirë.

Netëve të gjata
fshati në errësirë
s'jepte shenja jete
dukej shkretëtirë.

Në fshat heshtje varri
asgjë s'ndihej gjallë,
veq zërit të ndonjë shpendkeqi
e të qenëve në mahallë.

Njerëzit si statuje,
plot ankth e trishtim,
dëgjonin pas ffengjive
mbyllur me qilim.

Rënqethej gjithqka,
edhe gurët e kullës,
kur ndihej uturim e gjipsit,
a hapa të patrullës.

Pastaj dikush shkonte xxx
mes njerëzve si hije;
prap mallkim nënash
e vaj të ndonjë fëmije.

Përsëritej ky refren
nat për natë,
atë dimër të egër,
tepër të gjatë.

II

Kokë më kokë me fëmijët
bisedonim gjatë
por,xx s'e dinim mirë
ç'po bëhej në fshat.

Shihnim njerëz të huaj
ardhur nga qyteti;
e dinim se prej tyre
vinte gjithë qameti.

Bridhnin poshtë e lartë
me gjipsa e vetura,
me qizme të zeza
e veshje nga lëkura.

Mësimin dhe lojërat
në gjysmë na i kishin lënë
ishin bërë sa javë
që shkollën kishin zënë.

Thoshin se nuk flinin
tërë natën e gjatë,
ata njerëz të zi,
të zi sikur natë.

Se ç'u bënin burrave
ne atëher se dinim,
por edhe ne shihnim
se si shkonin,nuk vinin.

Shumë shkonin me pushkë
e vinin pa te;
të tjerët të mavijosur,
ofshanin por s'nxirnin zë.

Dhe kur nënat na friksonin
s'thonin:mos se murrashi!
xxx s'thonin as:mos se gogoli
por, "kujdes,vjen "udbashi""!

Kështu atë dimër
e mplakte fshati im,
mbështjellë me borë e mjegull
me ankth e trishtim.

III

Ç'do natë e vështroja
gjatë babain tim,
e në sy i lexoja
vuajtje,zemërim.

Kishte kohë që buza
nuk i qeshte fare,
rrinte e mendohej
dhe pinte cigare.

Unë veten pyesja shpesh
babai ç'kishte vallë?
pse i ishin shtuar ofshamet
dhe rrudhat në ballë?

Mendoja kështu qdo natë
e në sy s'më vinte gjumë,
s'e shihja se babai
halle kishte shumë.

IV

Një natë e zezë
sikur u shtua acari,
kur në shtëpin tonë
erdhi ofiqari.

Nuk dëgjova mirë
babait se ç'i tha,
por e pashë një letër
në dorë kur ia la.

Dhe shkoi nga erdhi,
u fut në errësirë;
babai mbeti në prakë
i shtangur,i ngrirë.

Pastaj u kthye nga ne
dhe na pa në fytyrë,
dhëmbët i shtrëngoi
dhe pështyu në errësirë.

Ashtu si babai
pështyva dhe unë.

ndej nga shkoi njeriu
që i thonshin "spiun".

Jashtë erësirë dhe nëna,
shikonte e nemitur
e me pezm mallkonte:
-"mjerë nëna që të,ka rritur!"

Fëmijët e tjerë
flinin nën velenxe;
ata s´dinin gjë
për letrën e zezë.

As unë nuk dija
ç´thuhej natë cop letër,
por shihja se babait
i sillte merzi tjetër.

V

Menjëherë të ngasërmen,
dikur natën vonë
erdhi hoxha i fshatit
në shtëpinë tonë.

Dhe gati gjithë natën
foli me babanë;
babai vetëm heshtte
dhe pinte duhan.

-"S´ke çka bënë kumbar,
i thoshte babait,
le të bëhet siç,është shkruar,
në dorë të allahut.

Shitoe edhe lopën
se s´bëhet kijameti
zoti është i pari
i dyti hyqmeti.

Se të dua shumë
prandaj ta bëjë këtë të mirë,
se miku i vërtet duket
në ditë të vështirë..."

Fliste kështu mullai
dhe sillte tespitë
shpesh lëpinte buzët
e i rrotullonte sytë.

Unë urreja hoxhën
me qyrkun e zi
droja mos babai
i shtonte ndonjë mërzi.

Sepse hoxhallarë
me zë të qjerë e të hollë,
e i kisha parë shumë herë
të shkonte në shkollë.

Shkonte e vinte
me njerëzit e zi
rrëqiste pastaj si hie
shtëpi më shtëpi.

Prandaj urreja hoxhën
me qyrkun e zi
e droja mos babai
i bënte ndonjë dredhi.

Por edhe babai
në darkë kur e përcolli
vështroi gjatë erësirën
dhe kokën e solli.

Dhe e ndjeva hoxhën
kur"dhelpër" i tha,
-"ma ke gjetur ditën
hoxhë maskara".

Të nesërmen kur u zgjova
pash një pushkë në mur
por lopa jonë e vetme
më s´ishte në ahur.

E shava mullanë,
ia shava dhe tespit
se më dhimbsej Laroja,
m´u njoftën edhe sytë.

Por e përmbaja dhimbjen
për lopën Laroj
se shpresoja që pushka
halle do të pakësoj.

VI

Një mëngjez babai
doli nga shtëpia,
se shkonte në shkollë
duke ik nga mërzia.

Na shikoj me dhimbje
dhe doli në borë,
dhkonte si drejtë vdekjes,
pushkën mbante në dorë.

Sa keq e ndjeva veten
unë brenda në shtëpi
kur kujtoja babanë
mes njerëzve të zi.

Dhe kur ai,pas pak,
u kthye përsëri,
fytyra ne na qeshi
të gjithëve në shtëpi.

Në fillim mendova
se babai kishte shpëtuar
por kur e pash ballin,
rrudhat i kishin shtuar.

Se ç´ndieva në zemër
sytë mu mbushën plotë
ndjeva dhe në dorë
të m´i lëmonte flokët.

Ato kohët e fundit
shpesh kështu vepronte;
vetëm më përkdhelte
dhe në sy më shikonte.

Më thoshte i menduar:
-"Ja rrite o bir..."
por s'fliste më gjatë
e kishte të vështirë.

Dhe sa herë që ai
kështu më shikonte,
më dukej se prej meje
diqka po kërkonte.

Më shikonte mua
shikonte mbi dollap
dhe thoshte me zë:
-"i gjallë nuk e japë" .

VII

Atë natë dimri
vonë,në shtëpi,
i erdhi babait
një shok i tij.

Ishin shokë lufte
shokë të pandarë,
por të bisedonin ashtu
kurrë s'i kisha parë.

Shikoja babanë xxxxx
dhe shokun e tij
e në sy u lexoja
halle e mërzi.

Flisnin plot urrejtje
dhe plot neveri,
për njerëzit e huaj,
për njerëzit e zi.

Dhe atë natë të ziun,
që kërkonte pushkë,
shpesh në gojë e zinin;
e kishin njohur në luftë.

-"Atëherë,thoshin ata,
kishte veshje tjetër,
kishte kryq të thyer,
kishte edhe mjekër".

Dhe sa herë atijë
emrin ja kujtonin,
plot pezëm në sy
dhëmbët i shtrëngonin.

-"Jo,thoshte babai,
s'duan veq armët tona,
por duan të na zhdukin
gjithqka që është e jona.

Duan që të zhdukin
gjithqka që është shqiptare,
emrin,gjuhën,plisin...
të na qesin fare.

Nuk kërkon mor,jo
veç pushkë e "allti"
por don gjakun tonë
qetniku i zi .

-"Ty mor kapuqbardhë,
lehtë,më tha s'të lëshojmë,
edhe top po të sjellësh,
tanks do të kërkojmë.

Dhe ia shihje në sy
etjen për gjak,
hakmarrjen për luftën
në Kosovë e Sangjakë.

Refrenin pastaj
ngjarje,histori...
dhe herë-herë ofshanin..
"ah,tradhëti,tradhëti!"

Flisnin me ofiqarin
dhe e quanin mashë,
se hante dhe pinte
bashkë me "udbashë".

E shanë hoxhën e fshatit
dhe dy a tre të tjerë,
që një pushkë të "udb"-së
e shitnin disa herë.

Flisnin dhe kërkonin
shpëtim nga ky ortek,
por nuk gjejnë rrugë,
ishte zënë çdo shtek.

"Nuk ka shpëtim,jo,
nga njerëzit e zi
veç te kalojmë kufirin,
t'ikim në Shqipëri.

Por,as kështu nuk bënë,
mohonin me kokë;
ku ti lëmë fëmijët,
si ta lëmë këtë tokë?

Pastaj të huajtë
mu këtë e kërkojnë,
që nga tokat tona
ne të na dëbojnë".

Unë shihja babanë
dhe shokun e tij"
e në ballë u lexoja xx
veq halle e mërzi.

Në sytë e tyre rrodhi
një valë e ngrohtë gëzimi,
vetëm kur po flisnin
rreth një fjalimi.

Unë nuk kuptoja mirë
ç'ishte ai fjalim,
por shihja se i ngjallte
shpresën babait tim.

Dëgjoja nga goja e tyre
shpesh fjalën liri,
Parti,Socializëm,
Mirëqenie,Begati...

Kosova e robëruar,
xhelatët e zi...
dhe shpesh e përmendnin
emrin Shqipëri.

Dhe sa herë që në gojë
zihej Shqipëria,
më dukej se babait
i hiqej mërzia.

-"Natë e zezë ka rënë,
por do të dal drita,
thanë duke u ndarë,
do t'i vij dita".

Kur u kthye babai
shikoi mbi dollap
dhe tha i vendosur:
-"i gjallë nuk e japë".

VIII

Atë natë dimri
shumë ëndërra unë pashë
plotë dritë e lule,
plot korba e "udbashë".

Në njërën prej tyre,
pashë një livadhë,
që ndahej në dyshe
nga një gardhë i madhë.

Andej shpend e lule,
hare e gëzim;
këndej ferra e bisha,
halle e trishtim.

Andej rrezet e kuqe
plot drit e diell,
këndej natë e zezë
e plot re në qiell.

Ne nga errësira
vështronim në qiell,
por gjithkund ishte natë
s'shihnim drit as diell.

Disa njerëz të zi
si ujqër e derra
e ruanin me armë
gardhin me therra.

Gjysma e livadhit,
dukej sikur ferr,
se gardhi ne bënte
hije edhe terr.

Por,se si shpërtheu
një zjar i kuq si gjaku
dhe me reze të kuqe,
qiellin e përflaki.

Retë dhe errësirën
dhe gardhin e zi
i digjte ky zjarr,
i bënte shkrumb e hi.

Ne me gaz e shpresë
shikonim në qiell,
se tani gjithë livadhi
do të kishte drit e diell.

Unë bërtita shumë
sa gjithqka ushtoi,
por për një qast babai
nga gjumi më zgjoi.

Atëherë unë kuptova
se në ëndërrisha tretur
dhe se babai
ende s'kishte fjetur.

Çdpate më pyeti
dhe flokët m'i limoi
e unë mezi prisja
ëndërrën t'ia tregoja.

Ai më shikonte
dhe ndëgjonte në heshtje,
e herë- herë fytyrën
ia mbulonte një buzëqeshje.

"Eh,mor biri im,
sa jeta është dhënë,
ëndërrën që ke parë
në jetë për ta vënë.

Që të bëhet kjo
qenka shumë vështirë,
për këtë u dashka gjaku
i bijëve më të mirë.

Por,kjo do të bëhet
patjetër biri im;
vetëm ti rritu
edhe bëhu trim!"

Dhe babai im kishte
kishte të drejtë;
koha po kërkonte
të rritesha më shpejtë.

Ato net kuptoja
edhe dy të vërteta;
se ëndërra të bukura kishim
e sa e zezë ishte jeta!

IX

Në një gjumë fëminorë
ëndërroja pranverën,
kur me forcë mushtuan
të trokitura në derë.

Vrapova në dritare
dhe kokën e zgjata;
jashtë dikush bërtiste:
"Otvorite vrata".

Dëgjova disa sharje,
një kërcitje të fortë,
pastaj disa hije
u futën në portë.

Ende sishim zgjuar
ne në shtëpi,
kur u futën mbrenda
njerëzit e zi.

Uh,sa të zezë kishin
ata njerëz fytyrën,
që hynë në shtëpi
bashkë me erësirën.

Dhe këta njerëz të huaj
i thoshin babait shpesh
disa fjalë të huaja
që unë si mereja vesh.

Por ç'ishin ato fjalë
e kuptova mirë,
kur ja lidhën duart
me pranga e zingjirë.

Në mes tyre babai
krënar po qëndronte;
i shihte drejtë në sy
e dhëmbët shtrëmgonte.

Na shikonte ne
shikonte mbi dollap
dhe më dukej sikur thoshte:
"i gjallë nuk e japë".

Mua shpesh më vinte
t'ia plasja vajit,
por s'qaja se kisha
turp prej babait.

Se sa herë m'e shikonte,
e kuptoja mirë,
më thoshte në sy:
-"tani u rrite bir..."

Pastaj aty ishin
dhe njerëzit e zi
e s'doja të më shihnin
me lot në sy.

Dhe shkoi babai
mes njerëzve të zi; "
"qëndroni e mos qani!
thoshin syt e tij.

Unë shtrëngoja dhëmbët
dhe nuk qava dot,
ndonëse syt i kisha
të mbushura me lot.

Fëmijët e tjerë
në vaj ishin shkrehur
nëna vërtet s'qante,
por e tëra ishte zbehur.

Ofshante ajo thellë
dhe vetëm mendohej;
oh,ç'dhembje e madhe
në ballë i lexohej!

Sa keq e ndjeja vehten
at ditë në shtëpi
kujtoja babanë
mes njerëzve të zi.

X

Ish mëngjes i ftohtë,
një mëngjes dimëror;
më një grup fëmijësh
ecnin nëpër borë.

Ç'do njëri tregonte
me lot në sy,
se ç'i kishte ndodhur
ato net në shtëpi.

Shumë shokëve të mi
u kishin marrë babanë;
dikuj-dikuj vëllezërit
e dikuj gjagjanë...

Më dhimbseshin të gjithë
si babai im
por,veqmas ndjeja dhembje
për mësuesin tim.

Atë e kishin marrë
pse libra kish lexue
dhe sepse në radio
Tiranën kish ndëgjue.

Ne të gjithë e donim
dhe ai shumë na donte;
sa tregime të bukura
na rrëfente e lexonte!

Dhe kur fliste për Kosovën
më kujtohet si sot,
se si dhembët shtrëngonte
e në sy i vinin lotë.

Sytë e tij të ëmbël
mbusheshin hare,
vetëm kur nanfliste
për një bot të re.

Sa më vinte keq,
sa më vinte vështirë,
Kur e mendoja të lidhur
mësuesin tim të mirë...

Dolëm mbi fshat në xxxxja
në maje të bregores;
që andej shkolla dukej
si në pëllëmbë të dorës.

Vështronim nga bregorja
mbi bor të shkrirë,
me ankth e trishtim
me zemër të ngrirë.

Shihnim atje poshtë
në oborr të shkollës
baballarët tanë
në mes të dëborës.

Qëndronim në këmbë
dhe nuk leviznin fare
nuk flisnin mes veti
as pinin cigare.

Rreth tyre "udbashët"
me veshje nga lëkura
mbi kokë u qëndronin
me pushkë e kacatarra

Dhe kur her pas here
ifutnin ndonjë brenda
neve në bregore
fort na rrihte zemra

U bërtisnin të huajtë
i shtynin,i shanin...
E kur i nxirrnin jashtë
as këmbët sí i mbanin...

Qëndruam në bregore
deri vonë në terr
derisa s'dukej shkolla
që ngjante në ferr.

Kapur dorë për dore
u kthyem duke kënduar,
këngën partizane
që mësuesi na e kis h mësuar.
Na dukej sikur këngët
na mbanin zemrat ngrohtë
se kështu e mposhtnim dhimbjen
dhe erën e ftohtë.

Dit për ditë
me motrat dhe vëllanë
mes borës, në rrugë
e prisnim babanë,

Ato ditë pritjeje
dhe ato netë,
plot me dhimbje ishin,
të gjata ishin vjetë.
Dhembja dhe urrejtja
më digjnin sikur furrë,
më dukej se babanëxxdxx
s'do ta shihja kurrë.

Me pikëllim në zemër
me lot në sy
ktheheshim pa babanë
vonë në shtëpi.

Atje gjeta nënën
në penxhere mbështetur
dhe çdo ditë më dukej
edhe më e tretur
Na shikonte gjatë
dhe floketë naj lëmonte
sytë i tumbulloheshin
dhe nofullat shtrëngonte.

Unë shihja se ajo
sytë i kishte plotë
ofshante thellë nga zemra
por,nuk derdhte lot

E shihja tek qante
te mallkoje e lotojë,
vetëm kur ne flinim
pa futur gjë në gojë.

Ne duronim urimë
ndonëse ishim fëmijë,
se babai,thoshte nëna,
nesër do të vijë.

Dhe na rrëfente nëna
shumë ngjarje dhe përalla
me dragoj e kreshnikë
e triměri të rralla.

unë çdo natë ëndërroja
vetën të fortë çelik;
fluturoja si dragua ,
luftoja si kreshnik.

XII

Ishte xxxë ende natë
ishte terr i zi,
kur ndjeva nëpër gjumë
hapa në shtëpi.

"Oh,ç'gëzim i madhë!
oh ç'ditë e bardhë!
lumë për mua,thirra,
babai pasha ardhë..."

Flaka tej velenxën,
u zgjova me rrëmbim;
se ç'ndjeva në zemër
e di veq shpirti im.

Por,kur hapa syt,
mbeta në vendë i ngrirë;
në shtrat rrinte babai
gjerë e gjatë i shtrirë.

"Ç'paska,thashë,babai
që rri i tendosur?
vallë pse fytyrën
e ka të mavijosur?

Pse athua ai
me lot në sy më kqyrëx?
a thua,pse nëna
është dyll në fytyrë?"

Pyesja kështu vehten
e s'përgjigjeshadot,
dhe si pa kuptuar
në sy më rrodhën lotë.

Dhe sigurisht do të qaja
me dënesë e ngashërim
po të mos thoshte babai:
-"eja biri im..."

Dhe u ngrit ngadalë,
e nuk rënkonte më,
buzëqeshte me zë,
thua s´kishte gjë.

-"Mos qaj biri im,
se tani je bërë burr!
e burrit,çfardo ti ndodhë,
lotët s´ja sheh kurrë..."

S´mundi të flasë më,
e kishte të vështirë,
por,se ç´kishte në zemër
i lexohej në fytyrë.

N´atë gjendje babanë
se kisha parë kurrë;
më dukej se në gjoksë
diqka i digjej furrë.

Më dukej sikur tymë
i dilte nga balli;
e kur dhëmbët i shtrëngonte
i dilnin xixa stralli.

I shtrëngonte grushtat
ofshante,por s´rënkonte;
më shikonte drejtë në sy
dhe flokët m´i lëmonte.

Më shikonte mua
shikonte mby dollap
dhe thoshte përsëri:
-"I gjallë nuk e japë."

XIII

I egër ishte ai dimër,
plot ngricë e acar
të tillë dimër fshati
kurrë nuk kishte parë.

Dimër i akullt
me erë e stuhi,
me ankth e trishtim
e njerëz të zi.

Me hapa patrullash
gjipsa e vetura;
dimër me " udbashë "
me veshje nga lëkura.

Gjithqka kishte ngrirë
nën qizme e dëborë,
veq zjarri i urrejtjes
rritej në krahëroré.

E shihja tek rritej
këtë zjarë gjithkund;
rritej në ç´do zemër,
rritej dhe tek unë.

E rrisnin "udbashët"
që nxinin mbi fshat;
e rriste babai
që dergjej në shtrat.

E rrisnin bisedat
që dëgjoja në shtëpi
nga goja babait
dhe shokëve të,tij.

Bisedat për luftën,
për njerëzit e zij,
ofshamjetk e thella:
-"ah,tradhëti,tradhëti...!"

Dhe nuk ëdëroja bukë
për barkun e urritur
por,të isha më i fortë,
të isha më i rritur.

Ç´do natë ëndërroja;
të rritesha më parë
për babain dhe të tjerët
hakun për ta marrë.

Dhe ndonëse i urritur
e të qullur sytë
ndjeja si atë dimër,
po rritesha çdo ditë.

E dit për ditë
shikoja mbi dollapë
dhe thosha si babai:
"i gjallë nuk e japë."

"Ç´të jetë vallë kjo pushkë
e fshehur mbi dollapë,
sa të thoshte babai:
-"i gjallë nuk e japë."

Pse e shiti larojën?
pse bleu pushkë tjetër?
a thua vallë,ç´të jetë
kjo pushkë e vjetër?"

Pyesja kështu vehten,
e ai më shikonte,
dhe më dukej sikur pyetjet
në ballë mi lexonte.

"Dëgjo more birë,
se tani je bërë burrë;
shikoje këtë pushkë
dhe mos e harro kurrë!

Se kjo pushkë,mor birë,
është nderi i shtëpisë;
është amanet i brezave,
është pushkë e lirisë..."

Dhe vështrimi i tijë
treti diku lartë,
e nëpër ballë kujtimet
i bridhnin varg-vargë.

Ai mbi tytë të pushkës
vështrimin hidhte prapë;
unë me vehte thosha:
"i gjallë nuk e japë".